

AKT THEMELIMI

I

SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“GOLUXURY” SHPK

Ortakët themelues si më poshtë:

- Shoqëria GOL S.R.L e perfaqesuar nga z. Giordano Ollari, lindur ne Parma, ITALI, me 28.09.1964, banues ne Via Milano, 4, Parma, ITALI, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me numer identifikimi 4417925AA.
- Z. Ervis Xibraku, lindur ne Shqiperi, me 01.01.1988, banues ne, Via Priv.S.Anna, 4, Casteggio (PV), ITALI, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me numer identifikimi CA23091CW,

Pjesa e përgjithshme

Bazuar në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Ligjin Nr. 9723 datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, sot me datë 28/12/2023 hartojnë këtë Akt – Themelimi si më poshtë vijon:

NENI 1

Emri

Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar mban emrin “GOLUXURY”. Ndryshimi i emërimit të shoqërisë mund të bëhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

NENI 2

Forma

Shoqëria tregtare “GOLUXURY”, ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

NENI 3

Zyra Qëndrore

3.1 Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar “GOLUXURY”, do të ketë seline e saj qëndrore ne: Kavaje, Luz i Madh, zone kadastrale 3397, numer pasurie 23/72 - N1.

3.2 Ndryshimi i zyrës qëndrore të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

NENI 4

Objekti i veprimtarisë

Shoqëria ka si objekt aktiviteti në Shqipëri dhe jashtë:

Brenda fushëveprimit dhe kufijve të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi herë pas here, shoqëria ndjek qëllimin e saj korporativ duke kryer aktivitetet:

- Të prodhimit, tregtimit (edhe telematik, i ashtuquajtur. "on-line") me shumicë dhe pakicë, si dhe përfaqësinë, me apo pa magazinë, të veshjeve të çdo lloji dhe vlere, duke përfshirë aksesorë, këpucë dhe veshje intime, bizhuteri, argjendari, parfume dhe kozmetikë, syze, artikuj mobilimi dhe aksesorë mobilimit, orë;
- shitblerja e veshjeve të çdo lloji dhe vlere, përfshirë aksesorët, këpucët dhe veshjet intime;
- shitblerja e produkteve joushqimore në përgjithësi, me shumicë dhe pakicë;
- konsulencë në sektorin e veshjeve dhe aksesorëve, këpucëve, veshjeve intime dhe në përgjithësi në sektorin e veshjeve dhe aksesorëve;
- menaxhimin e bareve, restoranteve, picerive, salla të lojërave, lokaleve me vetë-shërbim, dyqaneve me fast food, sallave e vallëzimit, dhomave të çajit, në përgjithësi lokaleve publike të lidhura me aktivitetet argëtuese dhe të kohës së lirë.

Shoqëria do të kryejë çdo veprim tregtar, pasurie të tundshme dhe të patundshme, financiar (përfshirë marrjen e detyrimeve dhe lëshimin e garancive, garancive bankare, pengjeve, hipotekave ose garancive të tjera reale, gjithashtu në favor dhe për detyrimin e palëve të treta, por me përjashtim të mbledhjes së parave dhe ushtrimit të kredisë) që konsiderohet i nevojshëm dhe i dobishëm për realizimin e qëllimit të shoqërisë.

Shoqëria mund të marrë, në mënyrë jo kryesore, aksione në biznese ose shoqëri të tjera me qëllime të ngjashme ose të përafërta dhe në përgjithësi të kryejë çdo veprim që, qoftë edhe vetëm në mënyrë indirekte ose ndihmëse, kontribuon në arritjen e qëllimit të shoqërisë, duke përfshirë kontratat e "franchising".

NENI 5

Kohëzgjatja

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një periudhë të pakufizuar.

NENI 6

Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit

Shoqëria tregtare "GOLUXURY" SHPK mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë vendit.

NENI 7

Përgjegjësia e Ortakëve

Ortakët nuk përgjigjen për detyrimin e shoqërisë "GOLUXURY" SHPK dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara prej tyre.

NENI 8

Kapitali i Regjistruar dhe Kuotat

8.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "GOLUXURY" SHPK është 40.000 Euro (dyzet mijë) euro, e konvertuar ne monedhen Leke ne vleren 4.080.000 Leke, (kater milion e tetedhete mijë) leke, e ndarë në 2 kuota, i cili është nënshkruar nga ortakët.

8.2 Ortakët kanë kontribuar në krijimin e kapitalit të shoqërisë dhe zotërojnë kuotat e tyre në këtë mënyrë:

- Shoqëria GOL S.R.L zoteron 1 koute te barabarte me 90% te kapitalit, ne vlere 36.000 euro, (tridhete e gjashtemije) euro, e konvertuar ne monedhen leke ne vleren 3.672.000 leke, (tre milion e gjashteqind e shtatedhete e dymije) leke.
- Z. Ervis Xibraku, zoteron 1 kuote te barabarte me 10% te kapitalit, ne vlere 4.000 euro, (kater mijë) euro, e konvertuar ne monedhen leke ne vleren 408.000 leke, (katerqind e tetemije) leke.

NENI 9

Organet e shoqërisë

9.1 Organet e shoqërisë janë:

- Asambleja e ortakëve
- Administratori

Detyrat e organeve të shoqërisë do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.

9.2 Në rast zmadhimi të kapitalit të regjistruar të shoqërisë, të gjithë ortakët kanë të drejtë të nënshkruajnë dhe shlyejnë pjesët e kapitalit të zmadhuar në proporcion me pjesëmarrjen e tyre në kapital.

NENI 10

Administratori

10.1 Shoqëria administrohet nga një administrator që emërohet dhe shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme. Afati i emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje. Administratori i shoqërisë është Z. Ylli Bjedi.

NENI 11


Të gjitha mosmarrëveshjet midis ortakëve duhet të zgjidhen me mirëkuptim. Në rastet kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim secili prej ortakëve ka të drejtë t'i drejtohet për zgjidhje gjykatës kompetente.

Ky Akt-Themelimi përpilohet në 4 (katër) origjinale në gjuhën shqipe.

ORTAKËT THEMELUES

GOL S.R.L

**E perfaqesuar nga
Z. Giordano Ollari**



GoL s.r.l.
Borgo G. Tommasini, 7
43121 PARMA
Partita IVA 02853890347

Z. Ervis Xibraku



Durrës 28/12/2023

